




INFORMACIONE

JANAR - SHKURT - MARS 2006

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

CITIVS ALTIUS FORTIVS

I pari përfaqësim i Shqipërisë në Lojërat Olimpikë Dimërore...



Sponsorë Krenarë të Pjesëmarrjes së Shqipërisë në "Torino 2006" (Lojërat Olimpikë Dimërore, edicioni XX)



BIRRA TIRANA



Sponsor | Divizës

Marketing Distribution



Furnizues Zyrtarë:



Mbeshtetës:



Partnerë:



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar



Ministria e Turizmit, Rinisë, Kulturës dhe Sporteve



Chamber of commerce and industry Tirana - Albania



6 Janar *Federata Kosovare e Hendbollit vizitë në KOKSH*

Presidenti dhe Sekretari i federatës së Kosovës, i shoqëruar nga z. Myrteza Myftari President i Federatës Shqiptare të Hendbollit, zhvilluan një takim pune me Sekretarin e Përgjithshëm të KOKSH z. Stavri Bello në mjediset e KOKSH.

Miqtë përfaqësues të Federatës Kosovare të Hendbollit informuan mbi arritjet e sportit të Hendbollit në Kosovë dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm e të ndërsjellë me Federatën Shqiptare të Hendbollit. Gjithashtu në këtë takim u diskutua edhe për iniciativa të përbashkëta për të organizuar aktivitete rajonale me vendet kufitare dhe për këtë ka bisedime nga të dy palët me Federatën e Hendbollit të Malit të Zi. Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. S.Bello u shpreh se KOKSH është i gatshëm të mbështesë iniciativa të tilla dhe të ndihmojë me mundësitë e tij.

13 Janar *Komisioni i Sportistit të KOKSH*

Kryesuar nga Atletja Olimpik Klodiana Shala, zhvilloi në ambientet e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar mbledhjen e tij të parë për katërvjecarin 2005-2008, me qëllim konsolidimin e kësaj strukture pranë KOKSH dhe kryerjen e aktivitetit të saj në interes të Sportistëve Shqiptarë dhe të dëgjimit të zërit të tyre.

Objekt parësor i Rendit të Ditës së kësaj mbledhje ishte: Prezantimi i anëtarëve të këtij komisioni; Hartimi i Rregullores së funksionimit të Komisionit të Sportistit dhe të ndryshme.

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, që mori pjesë në mbledhjen e Komisionit, theksoi se: ky komision duhet të synojë t'i bëjë gjërat vërtetë të lëvizin, në interes të përfaqësimit të zërit të sportistëve në familjen Olimpikë.

13-15 Janar *Olimpiku Special "Java Europiane e Basketbollit"/ Elbasan*

Ky ishte një Projekt i Olimpikut Special Euroaziatik dhe mbështetur nga 'FIBA Europë' për Promovimin e Sportit të Basketbollit 'si mjet për ti dhënë mundësi fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kuafizuara intelektuale dhe fizike që këta individë jo vetëm të argëtohen me këtë sport, por edhe të aftësohen dhe të integrohen në shoqëri'.

Ky aktivitet i realizuar me sukses në qytetin e Elbasanit nga Olimpiku Special Shqiptar nën emërtimin "Festa e Basketbollit", ku KOKSH gjithashtu ishte një mbështetës i tij, provoi se edhe Shqipëria ishte pjesëmarrëse e realizimit me sukses të këtij projekti. Presidenti z. Hysen Domi mori pjesë dhe përshëndeti në emër të KOKSH.

20 Janar *Mbledhje e Komisionit Financë-Marketing*

Komisioni i Financë Marketing të KOKSH zhvilloi në zyrat e KOKSH mbledhjen e radhës, rendi i ditës i së cilës përmbante:

- Hartimi i Rregullores së Komisionit
- Çështjet financiare të KOKSH
- Të ndryshme

20-21 Janar *AOSH në Kongresin Ndërkombëtar: "Pierre de Cubertin" dhe bashkëpunëtorët e tij 1889-1915".*

Presidenti dhe Drejtori i Akademisë Olimpikë Shqiptare në Kongresin Ndërkombëtar: "Pierre de Cubertin" dhe bashkëpunëtorët e tij 1889-1915" organizuar nga Akademia Olimpikë Kombëtare e Italisë, në Pinerolo (Torino). Olimpikë Shqiptare u përfaqësua nga z. Bardhyl Misja, President i AOSH dhe z. Arben Kaçurri, Drejtor.

19 Janar *Komisioni i Kualifikimit të KOKSH*

Komisioni i Kualifikimit të KOKSH zhvilloi mbledhjen e radhës dhe të parën për vitin 2006. Z. Arian Konomi ishte përfaqësues i MTKRS me ftesë të KOKSH. Në Rendin e ditës mbledhja përmbante:

1. Diskutim rreth kualifikimeve për vitin 2006, projekte të Solidaritetit Olimpik:

- Zhvillimin e strukturave kombëtare të trainerëve sportive (*kurs për trajnerë 3-mujor me specialistë ndërkombëtar në Shqipëri*);
- Bursa për Trajnerë, kualifikim 3-mujor jashtë shtetit;

2. Programi i ICMG (Komiteti Ndërkombëtar i Lojrave Mesdhetare)

- Seminar për Formatorët Sportivë;
- Seminar mbi Metodologjinë e Stërvitjes dhe Kërkimit të Talentit;
- Kurs Trainimi për trajnerët e Sporteve në programin e Lojrave Mesdhetare.



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar
Albanian National Olympic Committee



Shqipëria në Lojrat Olimpike Dimërore "Torino 2006",

një partneritet i:

MTKRS – KOKSH – FSH Ski – BDHTI



GALA OLIMPIKE
e përcielljes së Delegacionit Olimpik Shqiptar për në "Torino 2006" në Hotel Tirana International, Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Alfred Moisiu dorëzon Flamurin Shqiptar Skiatorit Erion Tola i cili do të përfaqësojë Shqipërinë në Lojrat Olimpike Dimërore "Torino 2006".

31 Janar Kryeministri i Shqipërisë z. Sali Berisha pret delegacionin Olimpik Shqiptar

30 Janar Presidenti Domi pret Skiatorin Tola dhe Trajnerin e tij

Presidenti i KOKSH z. Domi priti në një takim zyrtar skiatorin i cili do të përfaqësojë Shqipërinë në Lojrat Olimpike Dimërore Erjon Tola dhe trajnerin e tij z. Roberto Bonavita. Të pranishëm në këtë takim ishin Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH dhe Presidenti i Federatës Shqiptare të Skive i cili është njëkohësisht edhe Shefi Misionit në këto lojra. Në këtë takim Presidenti Domi ndau Kartat e Akreditimit të pjesëmarrësve të Delegacionit Olimpik të cilat janë pasaportat e pjesëmarrjes në Olimpiadë.

31 Janar konferencë Shtypi: në MTKRS

Anëtarët që përbëjnë Delegacionin Olimpik Shqiptar janë tashmë të gjithë së bashku dhe priten nga zv. Minsitri i MTKRS.



Presidenti i KOKSH Domi, Zv. Ministri i MTKRS Alibali, Presidenti i BDHT&I Bregasi gjatë konferencës për shtyp në MTKRS



1-10 Shkurt *Skuadra Shqiptare në Fshatin Olimpik të Torino 2006*

Skiatori Shqiptar Erion Tola, Shefi i Misionit z.Shkëlqim Memaj dhe treneri z.Roberto Bonavita, janë nisur drejt Torinos për të përfaqësuar Sportin Shqiptar të Skive në Olimpiadën e 20 të Lojrave Olimpikë Dimërore "Torino 2006". Më 2 Shkurt anëtarët e skuadrës Shqiptare i janë bashkuar banorëve të tjerë të Fshatit Olimpik të Torino 2006, të ardhur nga të gjitha kontinentet. Po në këtë ditë në fshatin Olimpik është ngritur edhe flamuri Shqiptar ndërmjet 84 flamurëve të vendeve pjesmarrëse. Delegationit Shqiptar, më datë 8 Shkurt iu bashkua Presidenti i KOKSH z.Hysen Domi dhe Sekretari i Përgjithshëm z.Stavri Bello.

2 Shkurt *Presidenti i Federatës Shqiptare të Atletikës pritet në KOKSH.*



Presidenti i KOKSH z. Hysen Domi dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Stavri Bello, priten në zyrat e KOKSH për një takim pune Presidentin e ri të sapozgjedhur të Federatës së Atletikës z. Fatos Shehaj. I shoqëruar nga z. Pavllo Mihali, z. Shehaj foli për vizionin etij si president në drejtim të FSHA dhe për bashkëpunimin dhe sigurinë e korrektësisë në marrëdhëniet institucionale edhe me KOKSH. Presidenti i KOKSH theksoi mbështetjen dhe vëmëndjen e KOKSH për sportistët e atletikës dhe për oportunitetet që Programi i Solidaritetit Olimpik ofron për të gjithë sportistët

23 Shkurt *Presidenti i KOKSH z. Domi, merr pjesë në tryezën e rrumbullakët të MTKRS.*

Tryeza me temë „ Sporti – Mjet Edukimi, mënyrë e shëndetëshme jetese dhe kohezioni social i fëmijëve dhe të rinjve“ u ërshëndet nga Ministri i MTKRS z. Bujar Leskaj. Presidenti i KOKSH ishte i ftuar si folës i panelit lidher me „KOKSH Si Promotor i Lëvizjes Olimpikë në vend.

2 Shkurt *Mbledhje e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv*



Në ambjentet e KOKSH më datë 2 Shkurt 2006, nën drejtimin e Juristit z. Skënder Begeja, ka zhvilluar mbledhjen e radhës Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS). Me ndryshimet e bëra në ligjin e ri të Sportit, Këshilli i Arbitrazhit Sportiv u mblodh për të diskutuar sipas rendit të ditës i cili ishte:

Mendime rreth funksionimit të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv, nisur nga ndryshimet e ligjit të Sportit Nr. 9376, datë 21/04/2005.

7 Shkurt *Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH*



Komiteti Ekzekutiv i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, në prag të fillimit të Lojrave Olimpikë Dimërore "Torino 2006", me kryesimin e Presidentit të KOKSH z. H.Domi, është mbeldhur në zyrat e KOKSH ku ka diskutuar mbi pikat e poshtëshënuara të rendit të ditës.

Rendi i ditës:

- . Përgatitjet për Lojrat Olimpikë Dimërore "Torino 2006"
- . Anëtarësimi i Federatës Shqiptare të Boëling dhe Shoqatës Sportive të Studentëve të Shqiprisë
- . Mbledhje e Komisionit të Kualifikimit
- . Mbledhje e Komisionit të Financës dhe Marketingut
- . Mbledhje e Komisionit të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv

**Konkurimet e Skiatorit Shqiptar Erjon Tola,
pjesmarrës në
Lojrat Olimpikë Dimërore
“Torino 2006”**

Konkurimi i parë

Data: 18 Shkurt 2006
Disiplina: Ski Alpine / Super Gjigand
Vendi: Sestriere - Borgata
Renditja: i 56 nga 63 konkurues
Koha: 1:44.27

Konkurimi i dytë

Data: 20 Shkurt 2006
Disiplina: Slalom Gjigand
Vendi: Sestiere Colle
Raundi I koha: 1:30.87
(i 39 ndër 82 konkurues)
Raundi II koha: 1:32.02
Renditja
përfundimtare: i 35 ndër 82 konkurues
Koha totale: 3:02.89

Konkurimi i tretë

Disiplina: Slalom
Data: 25 Shkurt 2006
Vendi: Sestiere Colle
Renditja: Nuk e përfundon garën, skuafikohet.

**26 Shkurt Ceremonia Madhështore e Mbylljes së
Lojrave Olimpikë Dimërore „Torino 2006“.**

**1 Mars Solidariteti Olimpik - FIVB- KOKSH - FSHV
Kurs Teknik i Kualifikimit të Trainerëve të Volejbollit**



Ekipi Olimpik Dimëror Shqiptar në një nga seancat stërvitore në Fshatin Olimpik

11 Shkurt “Torino 2006” – Ceremonia e Hapjes

Me një ceremoni madhështore kanë hapur siparin Lojrat e 20-ta Olimpikë Dimërore “Torino 2006” në Torino të Italisë. Në një mbrëmje gala të ndërthurur me elementë të artit, kulturës sportit dhe spektaklit, Lojrat Olimpikë Dimërore “Torino 2006” u shpallën zyrtarisht të hapura nga Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar z. J. Rogge. Personalitete dhe figura të shquara dhe shumë të njohura të politikës, artit, sportit, etj morën pjesë në ceremoninë e hapjes së këtyre lojrave. Shqipëria, e cila për të parën herë pjesëmarrëse në këto lojra Olimpikë, parakaloi e dyta në radhë sipas protokollit të prezantimit të shteteve pjesëmarrëse dhe ku flamurbajtësi ishte skiatori Shqiptar Erjon Tola.

KOKSH, në përmbushje të vizionit të tij afatgjatë për një strukturë kombëtare të Trainerëve të kualifikuar; në vijim të programeve të Solidariteti Olimpik, për vitin 2005-2008, të rekomanduara nga SO për Federatën Botërore përkatëse, këtë here organizoi në bashkëpunim me FSHV Kursin Teknik të kualifikimit të Trainerëve të Volejbollit.

Kursi 12 ditor (1-12 Mars 2006) u organizua në ambjentet e Shkollës Teknike “H. Fultz” u drejtua nga ekspertët e specializuar të FIVB dhe pikërisht:

z. Jivko Jetchev (Bullgar), Drejtor i kursit - Instruktor i nivelit III të FIVB që nga 1986 dhe njëkohësisht anëtar i Komisionit Teknik të FIVB, etj.

z. Zdenek Valasek (Çek), Instruktor i kursit - Lektor në Universitetin e specializuar në Lojrat Sportive, Instruktor i nivelit I pranë FIVB, etj.

Pjesëmarrësit, 24 në numër, 10 prej tyre femra, të ardhur nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, përbënin një auditor me trainerë të kategorisë së parë, sportistë dhe studentë. Kursi u dizajnuar në dy seanca në ditë – (paraditeve teori & mbasdite praktike, rrjedhojë kjo e një Programi të larmishëm dhe tepër intensiv.

Në ceremoninë e mbylljes, në datën 13 Mars 2006, në të cilën pjesëmarrësit u pajisën edhe me Certifikatat e kualifikimit të një kursi të tillë nga CIO dhe FIVB, ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello, Presidenti i FSHV z. Gjergj .Liçeja, dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Leonard Tase; si dhe Ekspertët e FIVBs.

Pas organizimit me sukses në muajin Dhjetor 2005 të Kursit Teknik për Kualifikimin e Trainerëve të Basketbollit, tashmë Voleibolli është sporti tjetër, i cili çon në numrin 2 të sporteve kolektive ((Basketboll dhe Volejbolli), të cilët përfitojnë nga programet e Solidariteti Olimpik, cdo vit këtë kurs derin në vitin 2008.

6 Mars ILO/IPEC - KOKSH “Zhvillimin nepermjet Sportit” (Berat, Korç, Elbasan)

Ne mjediast e KOKSH, Presidenti Hysen Domi dhe Sekretari i Pergjithshem Stavri Bello, zhvilluan nje takim pune me perfaqesuesen e Zyres se ILO/IPEC ne Shqiperi znj. Snezhi Bedalli, e cila eshte Menaxhere Kombetare e Projektit (ILO- Organizata Boterore e Punes; IPEC - Programi Nderkombetar i Eliminimit te Punes se Femijeve).



Ne kete takim u diskutua dhe u ra dakort qe ne kuader te misioneve te seciles organizate, aty ku keto misione konvergojne, dhe pikerisht ne ate te Zhvillimit dhe Integrimin nepermjet Sportit, keto organizma do te bashkepunojne per zhvillimin si fillim ne 3 qendra rinore, pilot ne Shqiperi (Berat, Korce dhe Elbasan), te aktiviteteve te koordinuara ne kuader te nje ‘miniprojekti’ te financuar nga ILO/IPEC dhe te mbeshtetu ne Burime Njerezore dhe ekspertize nga KOKSH ne bashkepunim me organizmat anetare te KOKSH, si Komitetet Olimpik Rajonale dhe Akademia Olimpik Shqiptare.

Nje takim tjetër do te vijojë tashme si nje faze e dyte e pregatitjeve pasi te perzgjidhet programi i sporteve dhe projekti qe do te aplikohet.

15 Mars Olimpiku Special Euro-Aziatik, në KOKSH



Presidenti i KOKSH Hysen Domi, priti Perfaqesuesit me te Larte te Komitetit Olimpik Special ne Shqiperi (President Salvador Kacaj; Sekretar i Pergjithshem z. Ismet Bellova) dhe nga ana e Olimpikut Special EuroAziatik z. Christo Velkov keshilltar i Jashtem per Europen Juglindore dhe Azine.

KOKSH, ka siguruar mbi vleresimin dhe sensibilizimin e Levizjes Olimpik Shqiptare për mbështetjen e kësaj shtrese të shoqërisë, për tu integruar nëpërmjet sportit dhe jo vetëm për një organizim sportiv, por për vlerat shoqërore të integritit të këtyre individëve në Shoqëri.

Z. Velkov nga ana e tij, shprehu duke cituar ish-presidentin Amerikan Ruzvelt se ‘ Nje shoqeri shfaq kulturen e saj, nepermjet asaj se sa kjo shoqeri trajton dhe mbron shpresat me te dobeta te saj’....ne kete kuptim misioni fisnik i mbeshtetjes se Special Olympics, eshte pertej vlerave sportive por mbi te gjitha eshte humanizem dhe Kulture.

Ky vit, pervecse aktivitetetve organizuar ne kete kuader, do te kete edhe pjesemarrjen e nje delegacioni te konsoliduar si gjithnje ne Lojrat Europiane dhe ato Boterore, te cilat do te zhvillohen ne Rome(Itali) dhe ne Shanghai (Kine) ne vjeshten e vitit 2006.

24 Mars Turneu Ndërkombëtar i Peshëngritjes

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH zhvilloi në Hotel Sheraton një takim me Presidentin e Federatës Europiane të Peshëngritjes z. Bszankoëski dhe Sekretarin e saj z. Casadei. Të mbërritur në Shqipëri me rastin e zhvillimit të Turneut Ndërkombëtar të Peshëngritjes “Kondo –Ferhati”, të shoqëruar nga Presidenti i FSHPeshëngritjes z. Esat Ademi dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Ilir Kraja, u fol për mbështetjen respektive të palëve në favor të Peshëngritjes Shqiptare, e cila po ecën në një rrugë të frytshme dhe me rezultate të suksesëshme në arenën ndërkombëtare.

17 Mars Mbledhje e Komisionit Teknik të KOKSH

Kjo mbledhje, e para për vitin 2006, nën drejtimin e Kryetarit të këtij Komisioni Fidel Ylli, pati përveç anëtarëve të këtij Komisioni, të pranishëm z. Hysen Domi, President i KOKSH; z. Stavri Bello, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH; dhe z. Bashkim Milo, Drejtor i Qendrës Kërkimore Sportive.

Në mbledhje u diskutua mbi:

1. Përcaktimi i kandidatëve për Bursat Mesdhetare për sportistët për "Pecara 2009". Komisioni Teknik vendosi që 3 Bursat Mesdhetare të përfitohen nga sporti i Peshëngritjes dhe Gjymnastikës, respektivisht me nga 1 sportiste femer (gjithsej 2 sportiste femra) dhe Mundja me një sportiest mashkull. Federatat përfituese duhet gjithashtu të financojnë pjesëmarrjen e trenerit shoqërues i cili do të jetë bashkë me sportistin gjatë trainimit. Sipas programit, trainimet do të organizohen nëpër qendrat stërvitore (kamp stërvitor) në një nga vendet e mesdheut.

Nga komisioni u vlerësua si shumë e rëndësishme shoqërimi i sportistit nga treneri ngase në të tilla trainime vlefshmëria për kualifikim është e dyfishtë. Për federatat duhet që të propozojnë kandidatë të denjë me synim për "Pescara 2009"

Pas mbërritjes së propozimeve nga federatat përkatëse, Komisioni do të mblidhet përsëri për të vlerësuar kandidatët e propozuara nga Federatat.



2. Në vijim të përgatitjeve drejt "Pekin 2008" z. Bello deklaroi se KOKSH është në pritje të komunikimit të CIO për aprovimin e kandidaturave të përzgjedhura dhe fillimin e Bursave Olimpikë "Pekin 2008" dhe më tej do të procedohet me programin e Talentëve të Reja (2006-2008).

23 Mars Ambasada Hungareze - Ceremoni e dorëzimit të çertifikatës si Trajner Ndërkombëtar Tenisi

Të ftuar nga Ambasadori Hungarez në Tioranë, Sandor Szabo, në Ambasadën e Republikës së Hungarisë në Tiranë, Presidenti i KOKSH dhe Sekretari i Përgjithshëm morën pjesë në ceremoninë e vecantë për nga lloji, të dorëzimit të certifikatës së Trainimit në Hungari Trainerit të Tenisit z. Shpend Kalesha.



Ambasadori Hungarez, mjaft i familjarizuar me sportin dhe me lëvizjen Olimpikë edhe nga e kaluara etij si sportist, shprehu kënaqësinë e vecantë, që tashmë, falë edhe mbështetjes nga kjo Ambasadë, në Shqipëri, u bë i mundur një trainim i nivelit të lartë për trenerin Kalesha, dhe shpreson që kjo do të jetë një shërbim i madh për tenis shqiptar dhe për vetë trenerin.

Tashmë falë këtij trainim intensiv, dhe përkushtimit të trenerit, diploma e tij, është e një niveli ndërkombëtar dhe kjo do t'i lejojë njohjen e tij si një trener i licencuar ndërkombëtar i këtij sporti.

Në këtë ceremoni, ishte i Pranishëm edhe Presidenti i Federatës Shqiptare të Tenisit z. Avni Ponari.

23 Mars Ambasadori i Arabise Saudite z. Abdullah S. Alhamadan priti në një takim pune në zyrën e tij Sekretarin e Përgjithshëm të KOKSH z. Stavri Bello.



Në këtë takim i cili u zhvillua në një atmosferë pozitive kortezie të dyanshme, u diskutua për stabilizimin e marrëveshjes dy palëshë, për çeljen e kanaleve të reja të bashkëpunimit, ndërmjet kësaj Ambassade dhe KOKSH, për bashkëpunimin me anë të sportit në promovimin e vlerave të shumanshme për të dy shtetet.



**SPORTISTËT OLIMPIKË MUNDËSOJNË ENTUZIAZMIN.
SPONSORËT OLIMPIKË MUNDËSOJNË MBËSHTETJEN.
SË BASHKU, ATA MUNDËSOJNË ENDRREN.**

Pavërsisht kësaj, disa kompani do të hiqen sikur janë sponsorë Olimpikë ose të krijojnë përshypjen jo të vërtetë sikur janë. Ata që e bëjnë këtë, vënë në lojë ëndrrën. Duke përdorur imazhet ose emblemat Olimpikë të pautorizuara, ose duke prezantuar veten e tyre sikur kanë një lidhje zyrtare me Lojrat Olimpikë, këto kompani çenojnë të ardhmen e Lojrave Olimpikë.

Vetëm Sponsorët Zyrtarë Olimpikë kanë të drejtë të përdorin emblemat dhe imazherinë Olimpikë në reklamat e tyre. Një e drejtë kjo, të cilën ata e kanë përfituar duke mundësuar produktet, shërbimet dhe mbështetjen financiare, e cila ndihmon që të bëhen të mundura Lojrat Olimpikë.

Me afrimin e shpejtë të Lojrave Olimpikë Torino 2006, tregoni mbështetjen tuaj për kompanitë që janë Sponsorë Zyrtarë Olimpikë dhe që janë licensuar zyrtarisht. Faleminderit.

THE WORLDWIDE OLYMPIC PARTNERS / PARTNERË MË SHTRIRJE BOTËRORE



KOKSH - SPONSORËT LOKALË NË SHQIPËRI

Sponsorë Krenarë të Pjesëmarrjes së Shqipërisë në "Torino 2006" (Lojrat Olimpikë Dimërore, edicioni XX)



Marketing
Distribution



TIRANA INTERNATIONAL

Furnizues Zyrtarë:

MURA

NORDICA

ASOLO



Thórtó

DIADORA *invicta*

